# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-445171**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “Thirrja për rrjetin MIA u mbyll me një sukses absolut”, Rama: Plot 245 aplikime nga ekselentë të sapodi plomuar |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/politika/thirrja-per-rrjetin-mia-u-mbyll-me-nje-sukses-absolut-rama-plot-245-apl-i586183` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 15 shtator 2026, 08:16:45 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 15 shtator 2026, 08:25:06 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `eea1f3458ece41d6073d9f31ace173a212a8aa02a4a474cba551fed744d1a53e` |
| TEKSTI | `c0472cbb355fb64704b83cf562b1aa3daf74eae230598fc286bdb09d9b203aba` |
| PAMJA | `0aa8463933a7ca458fcc41e5d8c69b8dc43de428f73f313640bc51f73e517b0a` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `1d522449fc0acc4f87872fece6a09aeb7b20b015c2709dc640ef5bc114d0695a` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/1d522449fc0acc4f87872fece6a09aeb7b20b015c2709dc640ef5bc114d0695a`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# “Thirrja për rrjetin MIA u mbyll me një sukses absolut”, Rama: Plot 245 aplikime nga ekselentë të sapodiplomuar

TemA
15 Shtator 2026, 10:25Politika TEMA



Kryeministri Edi Rama ka reaguar pas mbylljes së thirrjes për Rrjetin MIA, duke bërë me dije se janë regjistruar 245 aplikime nga të sapodiplomuar, gazetarë, informaticienë, organizata mediatike dhe studio dizajni.

Më tej, Rama theksoi se aplikantët kanë propozuar ide për thjeshtimin e gjuhës së shtetit, përmirësimin e informacionit për qytetarët dhe përdorimin e inteligjencës artificiale në komunikim.

Përballë akuzave se MIA është një “agjenci propagande e regjimit”, Rama ngriti pyetjen se si shpjegohet interesi i lartë për të punuar me këtë strukturë.

Postimi i plotë:

*THIRRJA për Rrjetin MIA u mbyll me një sukses absolut:*

*Plot 245 aplikime nga ekselentë të sapodiplomuar, gazetarë, informaticienë, organizata mediatike, studio dizajni grafik, dhe të tjerë akoma.*

*Kanë ardhur ide për ta bërë më të thjeshtë gjuhën e shtetit, më të kuptueshëm informacionin për qytetarët, më sistematike videot informatike, më prezente inteligjencën artificiale dhe më kreativ në formate rrjetin MIA.*

*Dhe këtu lind pyetja e madhe: Si ka mundësi gjithë kjo dëshirë për të punuar me “agjencinë e propagandës së regjimit”?*

*Ose “regjimi” e ka harruar fare zanatin e terrorit, ose propaganda e “regjimit” ka dështuar ose pastaj përralla e “regjimit” nuk bind më as ata që e tregojnë çdo ditë.*

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Pikë referimi për shqiptarët në Itali/ Inaugurimi i Konsullatës së Nderit të Shqipërisë, Rama në Napoli për ceremoninë]

20:30 Politika

Pagat e gjyqtarëve, Rama: Kurrë jo! Kjo nuk është gjuhë gjykatësi, po gjuhë ultrasi që bërtet në rrugë kundër VAR-it

19:40 Politika / 40 komente

[Pagat, lufta vazhdon pas 17 shtatorit/ Rexhaj: Një përpjekje e sofistikuar e magjistratëve për të marrë pushtet]

19:20 Politika / 11 komente



Begaj takohet me homologun Mohamed bin Zayed, vizita e parë e një presidenti shqiptar në Emiratet e Bashkuara Arabe

18:10 Politika / 12 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.